



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:189183

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05512839

CAP.nr1491/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, gjykatësi individual Dr.sc. Rafet Haxhaj, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen përmbarimore të kreditorëve Sh. M etj, të cilët i përfaqëson L. B nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Shtimes, Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpërblimit të licencimit dhe shpenzimet e procedurës, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj E.nr.521/2023 të datës 16.06.2023, me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e debitorit Komuna e Shtimes-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj E.nr.521/2023 i datës 16.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i përfaqësuesit të debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria Komunale e Arsimit, i ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit E.nr.521/23, të datës 22.03.2023, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj dhe mbetet në fuqi aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit E.nr.521/23, i datës 22.03.2023.

Kundër aktvendimit të atakuar, ka paraqitur ankesë debitori për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e debitorit të miratohet si e bazuar, aktvendimi ankimor të priset dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat lëndës rrjedhë se kreditorët kanë parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit me datë 22.03.2023 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ndaj debitorit në bazë të Pajtitimit Gjyqësor 2020:189183 të datës 07.12.2022, për shkak të borxhit, në shumën e përgjithshme 4,262.50€ si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën 757.00€.

Gjykata Themelore në Ferizaj me aktvendimin E.nr.521/23 të datës 22.03.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve Sh. M etj, kundër debitorit Komuna e Shtimes Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpërblimit të licencimit si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 5,527,50 €, si dhe shpenzimet e tjera të përmbarimit, në bazë të pajtitimit gjyqësor 2020:189183, të datës 07.12.2022, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimi deri në përfundim të përmbarimit, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogari bankare.

Kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, përfaqësuesi i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit.

Kreditorët në afatin e caktuar ligjor kanë paraqitur përgjigje në prapësim, me propozim që të që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e miraton në tërësi edhe gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit, për arsye se, vendimi i atakuar nuk është përfshirë në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Sipas vlerësimit të gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Apelit, vendimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës dhe se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë, për të cilat çështje, gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjyqtari i vetëm gjen se në rastin konkret nuk kanë ekzistuar asnjëra nga shkaqet e prapësimit të palës debitore të ushtruara kundër pajtitimit gjyqësor 2020:189183, të datës 07.12.2022 për lejimin e përmbarimit e që parashihet në nenin 71 par.1 të LPP-së e të cilat shkaqe do ta kishin penguar përmbarimin në këtë çështje juridike të përmbarimit. Pajtimi gjyqësor

2020:189183 i datës 07.12.2022, mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi konsiderohet dokument përmbarimor i paraparë në nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së.

Gjyqtari individual vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka refuzuar prapësimin e debitorit Komuna e Shtimes-Drejtoria Komunale e Arsimit, pasi Pajtimi Gjyqësor në bazë të cilit është lejuar përmbarimi përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit dhe i ka plotësuar kushtet ligjore nga nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69.4 të LPP-së, i cili përcakton se: ***“Baza për prapësim duhet të mbështet me prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi duhet të refuzohet”.***

Gjyqtari individual i gjykatës së shkallës së dytë gjen se debitori me asnjë provë nuk ka argumentuar pretendimet e tij. Në dispozitën e nenit 319.1 të LPK-së është parashikuar që: ***“Secila nga palët ka për detyrë që të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.*** Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë gjenë se, pala ankuese nuk ka arritur që të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe për këto arsye ka vendosur që ankesa e parashtruar të refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjykatësit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjykatësi individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 3.2 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.nr.1491/2023, me datë 26.03.2024

GJYKATËSI,  
Dr.sc. Rafet Haxhaj